



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____

Dt: 12.10.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/ L-040 dhe Përfundimit 01 nr. 06-45397-10/2 të miratuar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të dt:10.07.2015, me të cilin është aprovuar kërkesa e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik për formimin e Komisionit Monitorues të përfituesve të grandeve, me dt: 12.10.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni monitorues i përfituesve të grandeve, në këtë përbërje:

1. Silvana Domi , kryesuese e Komisionit
2. Teki Shala, anëtar
3. Burim Meqa, anëtar
4. Bekim Ermeni, anëtar
5. Afrim Bakalli, anëtar-përfaqësues i Këshillit Komunal të Bizneseve

2. Komisioni i përshkruar në pikën paraprake duhet të angazhohet për kryerjen e veprimeve si në vijim:

- Të bëjë evaluimin e rezultateve të aktiviteteve;
- Të bëjë verifikimin e artikujve dhe mallrave;
- Të bëjë vizita të terren dhe të shqyrton raportet periodike ;
- Të plotësoj dokumentin e formës së monitorimit të grandeve dhe këtë dokument t'ia dorëzojë drejtorit të DZHE-së çdo tre muaj ose çdo gjashtë muaj, apo në periudhë tjetër varësisht prej vlerësimit të rasteve ;
- Komisioni i monitorimit do të prezantoj në formën e monitorimit edhe komentet mbi mbarëvajtjen e shfrytëzimit të grandeve dhe rekomandimet mbi ndonjë veprim pasues sipas nevojës ;
- Komisioni monitorues mund ti kërkojë përfituesëve të grandit, që të sjellin raportin periodik në baza tre mujore ose gjashtë mujore dhe këto raporte duhet të mirëmbahen deri në përfundim të projektit ;
- Nëse ka problem në implementimin e grandit, Komisioni Monitorues do të vendosë për masat që do të ndërmerren, por jo të kufizuara në anulimin e grandit, në auditimin financiar ose aplikimin e masave ligjore.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

4. Vendimi iu dorëzohet:

- Anëtarëve të komisionit
- Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit

Kryetarja e Komunës,

Znj. Mimoza Kusari-Lila